

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj.	Adresa postare: Adresa elektronike: Nr. Tel:	Data: __/10/2020 Nënshkrimi:
---------------------------------	---	---------------------------------

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Lumi Valbona, Tropojë.

Nga 1 shtatori ka nisur intensivisht puna për nxjerrjen e rërës/zhavorrit në Lumin Valbona, pa informuar më parë publikun dhe pa patur një tabelë informuese mbi projektin, investitorin dhe afatet kohore. Punimet kryhen në pjesën e lumit të quajtur "Ura e Re" zona e Bujanit (me kordinata: 42°20'8.85"N; 20° 5'15.66"E). Një vend i vogël që më parë përdorej nga 2 familje dhe për bagëtinë është rikonstruktuar dhe është vendosur një ekskavator i madh dhe disa kamion të mëdhenj që hynë në lum dhe marrin rërë/zhavorr. Nga ora 8 e mëngjesit deri në 6 pasdite cdo gjysëm ore ngarkohet një kamion plot nga lumi. Puna ka vazhduar cdo ditë dhe po vazhdon edhe sot. Gjatë muajit të kaluar ekskavatori ka ndërruar vendndodhje, duke shkuar më në veri deri në Urën e Valbonës (Kordinata: 42°21'14.86"N; 20° 5'49.14"E). Lumi po aksesohet edhe në këtë pikë duke shtuar sasinë e rërës që largohet. Sot në 1 tetor jemi përpjekur të shohim deri sa lart rrjedhës vazhdon dukuria. Në bashkimin e lumenjve Valbona dhe Gashi, lumi Gashi është i stërbushur, dhe vazhdon i trazuar dhe i ndikuar deri aty ku kryhen punimet e HEC Drita në lumin Gashi në Tropojë nga Breçani ROSP (# K52116005E) Koordinatat (42 ° 23'34.7 "N 20 ° 05'47.4 "E), që do të thotë se një total i mundshëm prej 8 km i lumenjve Gashi dhe Valbona janë prekur.

Ndaj ne kërkojmë informacion në lidhje me punimet që po bëhen aty, përfshirë kopje të licencave për kryerjen e punimeve për marrje rëre/zhavorri, ndonjë komunikim të mbajtur me kompaninë, si dhe nëse kjo kompani ka leje mjedisore një kopje të raportit të VNM së thelluar të paraqitur në institucionin tuaj.

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Elektroknike

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____
-----------------------------	--------------------------	----------------------------------

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.